Kosova pranohet ne UEFA

nga Administrator
E martë, 03 Maj 2016 19:29

Sot ne takimin e pergjithshem te UEFA-s te mbajtur ne Budapest te Hungarise eshte pranuar kerkesa qe Federata e Futbollit te Kosoves (FFK) ka bere per anetaresim.
Me 28 vota pro, 24 kunder dhe 2 e pavlefshme, Kosova do te beje pjese ne institucionin me te rendesishem te futbollit ne Europe. Me kete pranim, shqiptaret do te perfaqesohen me 2 ekipe ne aktivitet europiane. Pranimi i Kosoves ne UEFA, i hap driten jeshile per te bere pjese edhe ne FIFA. Ky pranim mund te behet realitet ne takimin e ardhshem te FIFA me date 13 maj ne Meksise. Ne rast se Kosova pranohet ne FIFA atehere kombetarja kosovare mund te marre pjese ne eliminatoret e kampionatit boteror qe do te mbahet ne Rusi.